



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.266/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Arsim Muqa, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV) të paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Suharekë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar (pasafatshme) ankesa ZL.Anr.266/2025, e datës 19.10.2025, e parashtruar nga Arsim Muqa, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV) paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Suharekë për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 19.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datë 18.10.2025, kishte parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal. Kërkon rinumërim total të votave të kandidatëve të Lëvizjes Vetvendosje në Komunën e Suharekës. Gjatë gjithë kohës sa po numeroheshin votat online në QNK në Suharekë, në Qendrën e Votimit nr. 2418-Sh.F.M.U “Kongresi i Manastirit”, Studençan, kishte evidentuar se numri 6, me të cilin kishte garuar në listën e Vetëvendosjes, sipas pasqyrimit online të KQZ-së, kishte 3 vota personale.

Pasi i kishte shikuar votat në qendrat e votimit në Komunën e Suharekës, kishten vërejtur se në qendrën e lartcekur, ku me parë figurojshin 3 vota, ndërsa gjatë numerimit kishte 0 vota. Me tutje pretendon se ka pasur manipulime ose mospërputhje serioze ndërmjet leximit të fletëvotimeve dhe procesimit të tyre në bazën e të dhënave të KQZ-së.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet e palës ankuese se i janë bërë parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatet e kuvendit komunal, i cili pretendon se gjatë kohës sa po numëroheshin votat online në QKN në Suharekë në QV 2418, kishte evidentuar se kandidati me numrin 6, sipas pasqyrimit online të KQZ, kishte tri vota, për evidencën e tij ai ka bërë screenshot të ekranit dhe i ka ruajtur në telefonin e tij, ndërsa me datën 18.10.2025, duke i shfletuar votat e tij, në të gjitha QV në komunën e Suharekës kishte vërejtur se se në QV të larcekur figuronte me zero vota. Pala ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i të gjitha votave të kandidatëve të subjektit LVV për assemble komunale në komunën e Suharekës.

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Duke iu referuar Rregullës Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), konkretisht nenit 14 deri në nenin 20, të cilat përcaktojnë detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat teknike të QKN-së gjatë procesit të numërimit dhe publikimit të rezultateve, sqarojmë si vijon:

Në rastin konkret, qendra e votimit e pretenduar (2418) është futur në sistem më datë 15.10.2025 nga ekipet e numërimit të ndrrimit të dytë me transparencë të plotë dhe në prani të vëzhguesve, dhe të dhënat e saj pas kontrollit të cilësisë janë dërguar direkt në Qendren e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR). Në formularët fizikë të rezultateve për kandidatët, kandidati në fjalë ka të evidentuara 0 vota.

Tutje, KQZ ka theksuar se në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 19.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi gjatë numërimit në vendvotime, pas mbylljes së numërimit të vendvotimit lidhur me mospërputhje të votave.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 19.10.2025, në ora 12:53, ndërsa

parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 16.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Suharekës, Arsim Muqa, nga radhët e subjektit Lëvizja Vetvendosje (LVV), për shkak të parregullsive në numërim në QNK, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”,* si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZLAnr.266/2025 më datën 22.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.